# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-428715**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sherri që përfundoi me plumba, i shkoi në shtëpi për tu sqaruar, Vulaj vrau 24-vjeçarin – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/sherri-qe-perfundoi-me-plumba-i-shkoi-ne-shtepi-per-tu-sqaruar-vulaj-vrau-24-vjecarin/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 16:46:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 08:42:34 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1fc983937bd50cf411cd16c6b4978f8f7bea1173490a1e575bd732e84bd31910` |
| TEKSTI | `3ca273fee77bad71448debec70f30350491210434a6418aa6fdb1b3085ad3a3b` |
| PAMJA | `20d3ab4a9082fbd64cbc2281f13205bf13d39e962e10ac531a2a791e8f6bb4de` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bb53d4e33f4022f0ec69b836c9df2fe7e29b890a4fd2c9070a4b705b487da126` |
| E MËPARSHMJA | `8088bf2ec471b83f6ef8a1fd2f9cc630e2b6760308561483228ef1072cef1be7` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bb53d4e33f4022f0ec69b836c9df2fe7e29b890a4fd2c9070a4b705b487da126`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

mëngjesin e sotëm në Shkodër, ku 24-vjeçari Ylber Luli humbi jetën pasi u qëllua me armë zjarri, ndërsa babai i tij, Qamil Luli, mbeti i plagosur.

Gazetari i Vizion Plus, Bepin Kolvata mëson se gjithçka dyshohet se ka nisur pas një konflikti mes viktimës dhe Andri Vulajt, autor i dyshuar i ngjarjes.

Përplasja e parë mes tyre ka ndodhur gjatë orëve të mbrëmjes në një lokal në zonën e Gjuhadolit. Më pas, rreth orës 05:00 të mëngjesit, Vulaj ka shkuar në banesën e Ylber Lulit, me pretendimin se do të sqaronin konfliktin.

Sipas hetimeve paraprake, ai kishte me vete edhe një pistoletë. Gjatë bisedës, situata është përshkallëzuar dhe mes dy të rinjve ka nisur një përleshje fizike.

Në konflikt është përfshirë edhe babai i viktimës, Qamil Luli. Policia e Shkodrës dyshon se gjatë përleshjes, babë e bir kanë plagosur me thikë Andri Vulajn.

Në vijim të konfliktit, ky i fundit dyshohet se ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar në drejtim të 24-vjeçarit, duke i shkaktuar plagë të rënda që i morën jetën.

Pas marrjes së njoftimit, forcat e policisë kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë nisur menjëherë veprimet hetimore.

Efektivët kanë bërë ndalimin e Andri Vulajt, ndërsa kanë sekuestruar edhe armën e cila dyshohet se është përdorur në ngjarje.

5 **Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit**

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

armën e cila dyshohet se është përdorur në ngjarje.

Nga veprimet e para hetimore mësohet se Ylber Luli kishte qëndruar deri në orët e vona pranë banesës së tij, brenda automjetit, së bashku me një person tjetër.

Rreth orës 02:00 pas mesnate, ai është futur në banesë. Afërsisht tre orë më vonë, Vulaj është paraqitur në shtëpinë e tij, ku pas përplasjes fizike dhe plagosjes me thikë, dyshohet se ka qëlluar me armë ndaj Ylber Lulit.

Policia dhe grupi hetimor vijojnë punën për dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, përcaktimin e dinamikës së konfliktit dhe zbardhjen e plotë të përgjegjësive.

#Shkoder #Vrasja #ylberluli

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



KRONIKË

**Breshëria e plumbave në Mat, kush ishte...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 14:17



KRONIKË

**Mesazh me plumba ndaj një gruaje?!...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 12:19



KRONIKË

**Shpërthimi me tritol në Shkodër, policia j...**

Taulant Halili · Dje 00:27



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.